



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:170290  
Datë: 18.04.2024  
Numri i dokumentit: 05661123

**C.nr. 2018/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses J.B. e mitur nga Komuna e Pejës, ... të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor – babai A.B., e të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Nikqi&Associates” SH.P.K, me seli në Pejë, sipas autorizimit, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit - BKS, me seli në Prishtinë, Rr. “Lidhja e Pejës”, nr.12, me bazë juridike kompensim i dëmit nga baza e auto përgjegjësisë, vlera e kontestit 10.000 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prezencë të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, në seancë publike, të datës 04.04.2024, mori, ndërsa me datën 18.04.2024, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses J.B. e mitur nga Komuna e Pejës, ... të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor – babai A.B., dhe detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit - BKS, me seli në Prishtinë, Rr. “Lidhja e Pejës”, nr.12, që paditëses, në emër të kompensimit të dëmit, si pasojë e aksidentit të komunikacionit rrugor të shkaktuar me datën 31.05.2021, nga baza e auto-përgjegjësisë, të ia paguajë shumat e specifikuara si më poshtë:

**Dëmi jo material:**

- për dhimbjet e përjetuara fizike, në shumën prej 7.000 euro.
- për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm për jetë, në shumën prej 30.000 euro.
- për shëmtim, në shumën prej 2.000 euro.

**Dëmi material:**

- për ndihmë dhe kujdes të huaj, në shumën prej 900 euro.
- për ushqim të përforcuar, në shumën prej 630 euro.
- për shpenzimet e mjekimit, në shumën prej 460 euro.

**II. DETYROHET** e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit - BKS, me seli në Prishtinë, rruga “Lidhja e Pejës”, nr.12, që shumat e gjykuara si në pikën I në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paditëses, të ia paguajë me kamatë ligjore prej 8%, e cila kamatë për dëmin jo material do të

llogaritet duke filluar nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi (18.04.2024), e deri në pagesën definitive, ndërsa për dëmin material do të llogaritet duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë (02.08.2021), e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 1278 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**III. REFUZOHET** pjesërisht si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses J.B. e mitur nga Komuna e Pejës, ... të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor – babai A.B. nga Komuna e Pejës, përtej shumave të gjykuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike në shumën prej 3.000 euro, për zvogëlimin e aktivitetit jetësor në shumën prej 15.000 euro, për dhimbje shpirtërore për shëmtim në shumën prej 3.000 euro, për dëmin material në emër për kujdesin dhe ndihmën e huaj në shumën prej 1100 euro, për ushqimin e përforcuar në shumën prej 370 euro, ndërsa refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses J.B., e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor – babai A.B., që të dy nga Komuna e Pejës, me të cilën ka kërkuar kompensim të dëmit jo material në emër për friken e pësuar në shumën prej 7.000 euro, si e pabazuar.

## **A r s y e t i m**

### ***Pretendimet e palëve***

Paditësja e mitur, me përfaqësues ligjor të saj, e përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë me datën 02.08.2021, ka parashtruar padi ndaj këtu të paditurës, me bazë juridike kompensim dëmi nga baza e auto përgjegjësisë, vlera e kontestit 10.000 euro, të precizuar sipas parashtrësës së datës 26.03.2024, me të cilën ka kërkuar që e paditura këtu paditëses, të ia paguaj kompensimin e dëmit, ku në emër të dëmit jo material të paguaj shumën gjithsej 67.000.00 euro ndërsa në emër të dëmit material shumën prej 3,460.00 euro, me kamatë në lartësi prej 12%, të interesit vjetor e cila llogaritet për çdo ditë vonese, deri në pagesën e dëmshpërblimit, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim, e deri në pagesën definitive.

I autorizuari i palës paditëse, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, duke shtuar se e paditura me përgjigje në padinë nuk e ka kundërshtuar bazë juridike të kërkesës padisë meqenëse e njëjta i ka ofruar edhe ofertë për kompensim dëmi, të cilën e ka konsideruar si të ulët dhe jo në përputhje me natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësja. Në fund ka shtuar se gjatë rrjedhës së procedurës sipas kësaj çështje juridike – kontestimore e në veçanti nga provat përkatëse materiale të dorëzuara në gjykatë me anë të padisë dhe në seancat tjera siç ka qenë raporti dhe procesverbali policor, në tërësi është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë, e që e njëjta nuk është kontestuar as nga e paditura, me përgjigjen në padi të datës 18.07.2023. Tutje shton se në harmoni me ekspertizën lidhur me konstatimin dhe mendimin e ekspertëve nga degët përkatëse mjekësore dhe atë nga dega e neurokirurgjisë dhe nga dega e neuropediatriisë, ku është konstatuar se paditësja e mitur J.B. në aksidentin e datës 31.05.2021 ka pësuar lëndime tejet të rënda trupore, me zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 35%, i shprehur me dëmtim të përhershëm, manifestim të dhimbjeve fizike dhe frikës të gjitha intensiteteve, si dhe

shëmtimit trupor, të cilat zgjasin edhe sot e të cilat paditësen e mitur do ta përcjellin gjatë gjithë jetës së saj, ku është vërtetuar lartësia e kërkesëpadisë, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta miratojë si të bazuar e në harmoni me parashtrësën për precizim, të datës 26.03.2024.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë të specifikuar sipas listës së shpenzimeve.

E paditura, në përgjigje në padi ka deklaruar se nuk e konteston kërkesëpadinë e paditëses sa i përketë bazës juridike, mirëpo kontestuese është lartësia e kërkesëpadisë, e cila me qëllim të ekonomizimit të procedurës i ka ofruar një ofertë në shumën prej 5.500 euro palës paditëse si dhe mbulimin e shpenzimeve të procedurës, duke shtuar se për shpenzimet e mjekimit do të deklarohet pas pranimit të raportit të emergjencës i cili është i lexueshëm.

I autorizuari i të paditurës, në seancat gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padinë, e kundërshton lartësinë e kërkesëpadisë për faktin se shumat e kërkuar nuk janë ekuivalente me dëmin e shkaktuar tek pala paditëse, tutje ka shtuar thekson se për të paditurën nuk është kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, kontestuese mbetet lartësia e kërkesëpadisë, duke kundërshtuar precizimin e kërkesëpadisë për faktin se vlerat e kërkuar në precizimin janë të larta të cilat nuk janë në harmoni me natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësja dhe praktikën gjyqësore. Po ashtu ka shtuar se sa i përketë kamatës ligjore, ka kërkuar nga gjykata që të vendos në shkallën prej 8% nga dita e nxjerrës së vendimit, ndërsa lidhur me shpenzimet të procedurës të vendosi sipas suksesit në procedurë, duke kërkuar që gjykata të aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses pjesërisht si të bazuar për natyrën e lëndimeve të pësuar, duke i refuzuar pjesërisht shumat e kërkuar në precizim.

Për shpenzimet të procedurës nuk është deklaruar.

### ***Vërtetimi i gjendjes faktike***

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, në shqyrtimin kryesor-publik, gjykata sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse ka zhvilluar procedurën e provave dhe bëri administrimin e provave si: Leximi i pasaportës me të dhëna A.B.; Leximi i ekstraktit nga Zyra e Gjendjes Civile në Pejë, me datë lëshimi 23.06.2021 në emër të J.B.; Leximi i raportit i aksidentit me nr.2021-DR-..., i dt.31.05.2021; Leximi i procesverbalit mbi vend shikimin e aksidentit me nr. lëndës 2021-DR-..., i përpiluar nga Njësi i Rajonal i Komunikacionit Rrugor-Njësi i hetimeve të aksidenteve ne Pejë; shikimi i fotografie të automjetit GS YP 49; Leximi i fletë lëshimi nga QKUK –Klinika e pediatri-së-Departamenti Neuropediatër me nr. amzës me nr. të sëmundjes 3010; Leximi i kuponit me nr. fiskal 810123810 i dt.17.07.2021; Leximi i raportit specialistik i lëshuar nga Dr. Gent Panduri me dt.17.07.2021; Leximi i raportit nga konsulta i lëshuar me dt.17.11.2021, nga Dr. Armend Vuqiterna – pediatër neurologjisë; Leximi i udhëzimit për laborator i lëshuar me dt. 17.11.2021, nga Dr. Armend Vuqiterna; Leximi i kuponit fiskal me nr. fiskal 810106767 i dt.01.09.2021; Leximi i parashtrës nga Poliklinika Vita plus e lëshuar me dt.01.09.2021 përkatësisht i lëshuar nga Dr. Armend Vuqiterna; Leximi i parashtrësës e lëshuar nga QKUK

– Qendra diagnostike, Instituti i Radiologjisë për J.B.; Leximi i kuponit fiskal me nr. fiskal 810106767 i dt.30.06.2021; Leximi i parashtrës nga Poliklinika Vita plus, përkatësisht e lëshuar nga Dr. Armend Vuqiterna me dt.30.06.2021; shikimi i fotografitë-echo përkatësisht të lëshuara nga Vita plus të dt. 30.06.2021; Leximi echo e abdomenit e lëshuar nga Poliklinika Vita plus të dt.30.06.2021, përkatësisht nga Dr. Armend Vuqiterna; Leximi i fletë lëshimit me epi krize nga QKUK-klinika e anestologjisë dhe mjekimit intrerziv me nr. amzës 214/21; Leximi i raportit me kërkesë nga Spitali i Përgjithshëm-Reperti i Emergjencës në Pejë me dt.03.03.2022 me nr.458-0; Leximi i ekzaminimit enologjik i lëshuar nga poliklinika Vita Plus-Dr. Armed Vuqiterna me dt.25.02.2022; Leximi i ekzaminimit RM i kokës e lëshuar nga QKUK-qendra diagnostike, instituti i radiologjisë me dt. 22.12.2022, nga Dr. Sadik Kelmendi; Leximi i parashtrës e lëshuar nga Poliklinika Vita Plus – Dr. Armend Vuqiterna e dt.11.01.2022; Leximi i raportit nga konsulta i lëshuar me dt.28.12.2022 nga Dr. Teuta Haxhija-psikiater e fëmijëve; Leximi i flete-lëshimit me epi krize, me nr. amë të sëmundjes 3781, e lëshuar nga Klinika Universitare i Fëmijëve-Reperti i Kirurgjisë Abdominale, e përkthyer ne gjuhen shqipe me dt.21.05.2023, nga përkthyesi Nystret Kolica, e cila e ka te bashkangjitur të njëjtën në gjuhen serbe; Leximi i ekspertizës mjekësore e përpiluar nga ekspertet Bujar Kastrati – Neurokirurg dhe Naim Zeka Neuro-pediatër me dt.23.01.2024.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar.

Nga provat e administruara përkatësisht nga ekstrakti nga Zyra e Gjendjes Civile në Pejë, me datë lëshimi 23.06.2021 në emër të J.B. dhe pasaportës me të dhëna A.B., gjykata gjeti se paditësja këtu është e lindur me datën 14.11.2018, nga e cila erdhi në përfundim se e njëjta është e mitur dhe të njëjtën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor babai i saj A.B..

Nga provat shkresore të administruara, përkatësisht nga raporti i aksidentit me numër 2021-DR-..., e datës 31.05.2021, procesverbali mbi vendshiqimit e aksidentit i datës 05.07.2021, fotografit mbi vendshiqimin e aksidentit, gjykata gjeti se me datën 31.05.2021, rreth orës 13:30 min, ka ndodhur aksidentit trafiku, në mes të një automjeti dhe një këmbësori ku deri tek aksidenti ka ardhur për derisa drejtuesi i automjetit “A”, Chevrolet i cili ishte duke qarkulluar në rrugën R.H. në Pejë nga drejtimi i qendrës së qytetit në drejtim të varrezave të Kakariqit, me të arritur pikërisht përballë shtëpisë së të aksidentuarës këmbësore J.B., e cila së bashku me nënën e saj I.B. dhe me drejtuesen e automjetit A.B. me te cilën udhëtonin ishte ndaluar në drejtim të kundërt të lëvizjes, shikuar drejtimi i qendrës së qytetit, dhe gjatë zbritjes nga automjeti, nga pakujdesia e nënës së këmbësore I.B. përderisa fëmijun e saj e kishte për dore papritmas e lënduara J.B. vrapon në drejtim të shtëpisë së saj nga krahu i djathtë në të majtë duke mos e vërejtur automjetin ku përplasen në automjet, në anën e majtë të gomës së drejtuesit, të automjetit “A”, i cili menjëherë ndalohet në vend të ngjarjes, dhe këmbësoren të lënduarën J.B. nga vendi i ngjarjes me autoambulancë dërgohet në emergjencën e spitalit Rajonal në Pejë, ku e lënduara pas marrjes së ndihmës së parë mjekësore në emergjencë të spitalit, me autoambulancë të emergjencës dërgohet për tretman spitalor në Qendrën Klinike Universitare

e Kosovës Klinika e Pediatriisë Departamenti Neuropediatri, e cila ndalohet për tretman spitalor nga data 31.05.2021 dhe me datën 16.06.2021, ku nëna e fëmijës e cila ishte me të lënduarën këmbësoren J.B. ka ardh për deklaratë në hetimet e aksidenteve me datën 19.06.2021, të cilës i është marr deklarata, ku e cila ne hetimet e aksidenteve ka sjellë raportet mjekësore mbi lëndimet e pësura në aksident trafiku.

Gjykata, po ashtu gjeti se paditësja pas ndodhjes së aksidentit përkatësisht lëndimeve të shkaktuara, ka kërkuar ndihmë mjekësore, me ç ‘rast e njëjta kishte pranuar tretman mjekësor nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë- Reparti i Emergjencës dhe më pas është transferuar në Qendrën Klinike Universitare Prishtinë, gjë e cila është vërtetuar në bazë të raporteve mjekësore përkatësisht fletëlëshimit nga Qendra Klinike Universitare Prishtinë me numër të amezës i historisë së sëmundjes: 3010 datës 07.06.2021-16.06.2021, raportit specialistik e datës 17.11.2021 e lëshuar nga Specialist i Pediatriisë- Neurologjisë Dr. Armend Vuqitërna, raportit Specialistik nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Ordinanca Fizioterapeutike me numër të protokollit 184 të datës 17.07.2021, e lëshuar nga fizioterapeuti Gent Panduri. raporti nga konsulta i lëshuar me dt.17.11.2021, nga Dr.Armend Vuqitërna – pediatër neorologjisë, udhëzimi për laborator i lëshuar me dt. 17.11.2021, nga Dr. Armend Vuqitërna, vizita neurologjike nga Poliklinika Vita plus e lëshuar me dt.01.09.2021 përkatësisht i lëshuar nga Dr. Armend Vuqitërna, kontrollat nga QKUK – Qendra diagnostike, Instituti i Radiologjisë për J.B., fotografitë-echo përkatësisht te lëshuara nga Vita plus te dt. 30.06.2021, echo e abdomenit e lëshuar nga Poliklinika Vita plus te dt.30.06.2021 përkatësisht nga Dr. Armend Vuqitërna, fletë lëshimi me epi krize nga QKUK-klinika e anestologjisë dhe mjekimit intrerziv me nr. amzës 214/21, raporti me kërkesë nga Spitali i përgjithshëm-Reparti i Emergjencës ne Pejë me dt.03.03.2022 me nr.458-0, ekzaminimi enologjik i lëshuar nga poliklinika Vita Plus-Dr. Armend Vuqitërna me dt.25.02.2022, ekzaminimi RM i kokës e lëshuar nga QKUK-qendra diagnostike, instituti i radiologjike me dt.22.12.2022, nga Dr. Sadik Kelmendi, kontrollat e lëshuar nga Poliklinika Vita Plus – Dr. Armend Vuqitërna e dt.11.01.2022, raporti nga konsulta i lëshuar me dt.28.12.2022 nga Dr. Teuta Haxhija-psikiater e fëmijëve.

Nga provat e administruara përkatësisht nga flete-lëshimit me epi krize, me nr. amë të sëmundjes 3781, e lëshuar nga Klinika Universitare i Fëmijëve-Reparti i Kirurgjisë Abdominale, e përkthyer ne gjuhen shqipe me dt.21.05.2023, nga përkthyesi Nystret Kolica, e cila e ka te bashkangjitur të njëjtën në gjuhen serbe, të bashkangjitura nga pala paditëse, nga të cilat gjykata gjeti se paditësja tani vuan nga sëmundja e kancerit, por që nga ekspertiza mjekësore e lartcekur e punuar nga ekspertët Dr. Bujar Kastrati Specialist i Neurokirurgjisë dhe Dr. Naim Zeka Specialist i Pediatriisë- Neurologjisë, nuk është konstatuar se sëmundja e tillë tek paditësja ka rezultuar si pasojë e lëndimeve të shkaktuara nga aksidenti i komunikacionit me datën 31.05.2021.

Meqenëse në rastin konkretë në mes palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë sa i përkëtë shkaktarit të aksidentit as sa i përkëtë natyrës së lëndimeve por vetëm lartësia e kërkesëpadisë, prandaj gjykata nuk u lëshua në arsyetimin e vendimit sa i përkëtë provave që i referohen bazës juridike të kërkesëpadisë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 321 të LPK-së.

Baza juridike që e paditura të jetë përgjegjëse që të bëjë kompensimin e dëmit, gjen mbështetje fillimisht duke u bazuar në dispozitën e nenit 136 paragrafi 1, të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), sipas të cilës dispozitë ligjore parashihet se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, po ashtu nenit 137 të po të njëjtit ligj i cili parashihet se: *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*, e lidhur me nenin 140 të po të njëjtit ligj i cili parashihet se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*, kurse me dispozitën e nenit 159.1 të po të njëjtit ligj parashihet se: *“në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësin në bazë të fajit”*, e lidhur me nenin 245 të po këtij ligji është paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka atë të drejte që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërjegje dhe në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij”*, e lidhur me nenin 19 të Ligjit për Sigurimet e Detyrueshëm nga Auto-përgjegjësia Nr. 04/L-018.

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesë padisë, gjykata, me propozimin e palës paditëse, ka nxjerr provën me ekspertizë nga lëmia e neurokirurgjisë dhe nga lëmia e neuropediatriisë e punuar nga ekspertët Dr. Bujar Kastrati Specialist i Neurokirurgjisë dhe Dr. Naim Zeka Specialist i Pediatriisë- Neurologjisë.

Ekspertët Dr. Bujar Kastrati Specialist i Neurokirurgjisë dhe Dr. Naim Zeka Specialist i Pediatriisë- Neurologjisë, bazuar në ekzaminimin e drejtpërdrejtë mjekësor dhe dokumentacionin mjekësor në shkresat e lëndës kanë arritur në përfundim se paditësja J.B. si pasojë e aksidentit të komunikacionit ka pësuar lëndime trupore si Coma cerebri Post Trauma, thyerje të basës së kafkës, gjakderdhje nën cipat e brendshme të trurit, gjakderdhje nën cipat e jashtëm të trurit, thyerje të ahtit tëmthor të kafkës, grumbullim i lëngut trunoshpinor nën cipat e jashtëm të trurit dhe dëmtim intra cerebral i trurit post traumatik, e që këto lëndime karakterizohen si lëndime të rënda trupore me pasoja të përhershme për paditësen të cilat janë manifestuar me dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë që kanë zgjatur disa sekonda sepse e dëmtuara në momentin e lëndimit e ka humbur vetëdijen, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 14 ditësh ose dy javësh, nga fracturat e kokës nga gjakderdhja intracerebrale, deri në veprimin e terapisë së ordinar, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm ka pasur 60 ditë, për shkak të dhimbjeve në regjionin e kockave të kafkës për shkak të frakturave të tyre, dhe me intensitet të ulët paditësja ndjen akoma edhe sot e kësaj dite dhimbje që manifestohen me dhimbje koke të qafës çrregullime të ekuilibrit të vështirësisë në ecje çrregullime të shikimit të herë pas hershëm, shëmtimin trupor në shkallë të ulët, ecje hemiparetike, humbje të ekuilibrit si dhe pamundësi për qëndrim në këmbë një kohë të gjatë. Zvogëlimi i aktivitetit jetësor është në shkallën 35% për shkak të lëndimeve morfologjike të trurit me funksion të dëmtuar cerebral që manifestohen me humbje të funksioneve të larta kognitive humbjen e aftësive gjykuese dhe humbje të memories baraspeshimit si dhe vështirësive në ecje duke u bazuar në kapitullin e parë pika 1.1.4 të tabelës mjekësore orientuese për vlerësimin e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, ndihma e personit

të tretë ka qenë i nevojshëm për 90 ditësh, për të gjitha aktivitetet bazike të dëmtuarës duke përfshi nevojat fiziologjike urinim, defikimi, veshmbathje, ushqimit për shkak të lëndimit të kokës si dhe vështirësive në komandimin e anësive të majtë të dorës dhe të këmbës së majtë dhe kurse ndihmë për veshmbathje dhe pacienti ka pasur nevojë pas lëndimit në kohëzgjatje prej katër orësh në ditë edhe për dy vite pas lëndimit. Ushqim i përforcuar prej 90 ditësh i pasur me proteina, minerale dhe vitamina. Rehabilitimi fiziko- terapeutik ka qenë i nevojshëm dy here në vit nga 21 ditë në pesë vitet e pas lëndimit për shkak të dëmtimeve morfologjike intracerebral, gjakderdhjes subdurale e cila ka qenë më e shprehur djathtas, dobësisë se katër anesiv me dominim të anësive të majta.

Për lartësinë e kërkesëpadisë dhe për kategoritë e caktuara për aspektin e dëmit jo material, gjykata ka vendosur duke u mbështetur në nenin 183 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, sipas të cilit parashihet se: *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”* dhe *“Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*, e lidhur me nenin 323 të Ligji Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore, i cili parasheh se: *“Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t’i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tilla do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë”* si dhe pati parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës, dhe qëllimin të cilit i shërben kompensimi i gjykuar, gjithmonë duke pasur parasysh, që kompensimi të jetë satisfaksionin, për të dëmtuarin, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditëses.

Duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jo material, natyrën e dëmtimeve trupore të shkaktuar për paditësen, moshën e saj, vlerësimin të ekspertizave mjekësore përkatësisht ekspertizës nga lëmia e neurokirurgjisë dhe nga lëmia e neuropediatriisë e punuar nga ekspertët Dr. Bujar Kastrati Specialist i Neurokirurgjisë dhe Dr. Naim Zeka Specialist i Pediatriisë- Neurologjisë, të cilën gjykata në tërësi i ka pranuar konstatimet të eksperteve në fjalë. Konstatimet e dhëna nga ana e ekspertëve përkatës, të njëjtat përputhen në mes veti si dhe me provat tjera e posaçërisht me dokumentacionin mjekësor, raportin fillestar të aksidentit, procesverbalin mbi vend-shikimin e aksidentit, fotot e aksidentit dhe provave tjera që ju kanë bashkangjitur shkresave të lëndës, e të cilën ekspertizë nuk e kundërshtuan asnjëra nga palët ndërgjyqëse, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se shumatat e kompensimit të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditëses dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësojë paditëses satisfaksion që ajo të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompenzojë të mirat jo materiale nga të cilat është privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ajo do ta kishte po qe së e njëjta nuk do t'i kishte humbur, e gjithë kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat, natyrën e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve, kohëzgjatjen e tyre dhe kohën e nevojshme të shërimit, shëmtimit, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit jetësor. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material si dhe në lidhje me shumën e kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e të cilat gjykata i caktoi sipas bindjes së lirë konform nenit 323 të LPK-së po ashtu dhe dispozitive të LMD-së përkatësisht nenit 183 e lidhur me Udhëzuesin për Caktimin e Kritereve Orientuese dhe Lartësinë së Shpërblimit të Drejtë në të Holla të Dëmit Jomaterial të lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, Gj.A.nr.../2023, i datës 27.02.2023.

Gjykata vlerëson se shpërblimi i dëmit jo material, nuk është shpërblim i plotë, por është satisfaksion, për të dëmtuarin, çka në rastin konkret shumatat e gjykuara janë të drejta për të.

Për sa i përket kategorisë së dëmit material në emër të shpenzimeve mjekësore për shërimin e paditëses, gjykata arriti në përfundim se shumata e aprovuar si në pikën I të dispozitiv të këtij aktgjykimi u vërtetua nga provat e bashkangjitura në padi përkatësisht nga faturat – kuponët fiskal, të cilët janë mbledhur veç e veç, përkatësisht kuponit fiskal me nr. fiskal 810106767 i dt.01.09.2021, në shumën prej 20 euro, kuponit me nr. fiskal 810123810 i dt.17.07.2021, në shumën prej 400 euro, si dhe kuponi fiskal me nr. fiskal 810106767 i dt.30.06.2021, në shumën prej 40 euro, e që në total arrijnë shumën prej 460 euro, referuar në emër të shpenzime për mjekim.

Sa i përket dëmit material në emër të kujdesit dhe ndihmë e huaj si dhe ushqimit të përforcuar, gjykata ka caktuar kompensimin bazuar në ditët që ishte vlerësuar si e domosdoshme sipas ekspertizës mjekësore, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësja sipas mendimit të ekspertëve të mjekësisë si pasojë e aksidentit ka pasur nevojë për kujdes dhe ndihmë të huaj si dhe ushqim të përforcuar i pasur me vitamina dhe minerale, e njëjta shton se për këto kategoritë e dëmit, mund të caktohet edhe në mungesë të provave materiale, ngase është standard i ndërtuar tashmë nga praktika gjyqësore dhe vështirë i argumentuar. Andaj pas analizimit të gjitha provave, ka ardhur në përfundim se shumatat e gjykuara të shpërblimit të dëmit për këto kërkesa janë në përputhje me dëmin e pësuar sipas këtyre bazave.

Gjithashtu, gjykata vë në dukje se për këtë kategori të dëmit për paditësen, është vendosur brenda kufijve të kërkesëpadsisë, duke aplikuar nenin 2 par.1 të LPK-së, sipas të cilit: *“Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”*.

*Lidhur me pjesën refuzuese të kërkesëpadsisë*



Gjykata vendosi si në pikë e III (tretë) të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e refuzuar kërkesëpadinë përtej shumave të gjykuara, dhe atë: në emër të dhimbjeve fizike, zvogëlimit të aktivitetet jetësor dhe shëmtimit, ngase vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë, e po ashtu shumata e kompensimit që është ndërtuar nga praktika gjyqësore, ndërsa sa i përket kërkesës për dëmin material për kujdes dhe ndihmë të huaj si dhe ushqim të përforcuar, gjykata përtej shumave të gjykuara, të njëjtat i refuzoi në mungesë të provave materiale e përshtatshëmrisht bazuar në praktikë tashmë të ndërtuar gjyqësore, ndërsa kërkesa për dëmin jo material për frikën e përjetuar, gjykata refuzoi në tërësi shumën e kërkuar në mungesë të provave materiale, përkatësisht duke u bazuar në ekspertizën nga lëmia e neurokirurgjisë dhe nga lëmia e neuropediatrisë e punuar nga ekspertët Dr. Bujar Kastrati Specialist i Neurokirurgjisë dhe Dr. Naim Zeka Specialist i Pediatrisë- Neurologjisë, në të cilën një gjë e tillë nuk është konstatuar nga ekspertit, e që në të cilën ekspertizë nuk kishin vërejtje asnjëra nga palët ndërgjyqëse.

Prandaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate, shumata si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, paraqesin kompensim real për këtë lloj të kompensimeve dhe në mënyrë të drejtë për llojin e dëmit të pësuar.

Sa i përket pretendimit të palës paditëse se duhet të aplikohet kamata 12 %, një pretendim i tillë është tërësisht i pabazuar sepse bazuar në nenin 26.6 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga autopërgjegjësia (Ligji nr.04/L-018) është përcaktuar se: *“Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mos përmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruksi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruksi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.”*, ndërsa nga shkresat e lëndës, kërkesa për kompensimin e dëmit drejtuar të paditurës, vërtetohet se nuk janë plotësuar kushtet për tu aplikuar kjo dispozitë, për faktin se paditësja vetëm ka bashkangjitur kërkesën që i është drejtuar të paditurës mirëpo, e njëjta nuk përmban asnjë të dhënë se e njëjta është dërguar dhe pranuar nga e paditura, andaj meqenëse nga e njëjta nuk u arrit të vërtetohet se pala paditëse i është drejtuar me kërkesë palës së paditur, gjykata erdhi në përfundim se në rastin e tillë nuk janë plotësuar kushtet që kamata të përcaktohet në shkallës prej 12% por e njëjta, për kamatën vendosi duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve e në lidhshmëri me Mendim Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku sipas dispozitës së lartcekur, paragrafi 2, parashihet se lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, e cila kamatë për dëmin jo material do të llogaritet nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën e plotë, ndërsa për dëmin material do të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën e plotë.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë LPK-së, përkatësisht në dispozitat ligjore të nenit 463 par. 1 dhe 2 e lidhur me nenin 452 par.2, e lidhur me nenin 453.2, duke

mare parasysh suksesin e paditëses në këtë procedurë dhe provave të bashkangjitura në shkresat e lëndës si dhe bazuar në tarifën e OAK-së, lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve të palës paditëse dhe atë: për përpilimin e padisë në shumën prej 208 euro, për taksën gjyqësore në shumën prej 60 euro, për 4 seanca të mbajtura ku dy prej tyre janë mbajtur në shumën prej nga 270 euro (270 x 2) dhe dy prej tyre janë shtyrë pa fajin e palës paditëse në shumën prej (270 x 2 x 50%) si dhe për ekspertizat mjekësore në shumën prej nga 100 euro (100 x 2), e në total në shumën prej 1278 euro, ndërsa pjesa tjetër në shumën prej 478 euro, u refuzua si e pabazuar, ndërsa pjesa tjetër e shumës prej 300 euro e deponuar në emër të shpenzimeve për ekspertize, e njëjta shumë i është kthyer paditëses sipas aktvendimit të veçantë të datës 03.04.2024.

Nga arsyet e cekura si më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 të LPK - së.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.2018/21, me datë 18.04.2024**

**Gjyqtarja,**  
Rajmonda Kurteshi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë